



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E KURRIKULËS, CILËSISË DHE STATISTIKAVE

Nr. 840 Prot.

Durrës, më 07.04.2026

RELACION

Lënda: "Relacion mbi Analizën e Rezultateve të Pyetësorit për vlerësimin e shërbimeve të ofruara nga stafi ndihmës akademik dhe administrativ për studentët e Universitetit 'Aleksandër Moisiu', Durrës"

I nderuar Z. Rektor,

Ky raport analizon të dhënat e mbledhura nga një pyetësor i shpërndarë studentëve, me qëllim vlerësimin e shërbimeve të ofruara nga stafi ndihmës akademik dhe administrativ, kryesisht Sekretaria Mësimore. Analiza synon të nxjerrë në pah pikat e forta, dobësitë dhe fushat për përmirësim, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve për studentët.

Pyetësori përbëhet nga një sërë pyetjesh, duke përfshirë pyetje me zgjedhje të shumta dhe pyetje me përgjigje të hapura, që mbulojnë aspekte të ndryshme të ndërveprimit të studentëve me stafin. Përgjigjet janë analizuar si në aspektin sasior ashtu edhe cilësor, duke marrë në konsideratë jo vetëm shifrat, por edhe sugjerimet dhe komentet e studentëve.

Shpeshësia e frekuentimit të sekretarisë mësimore, përgjigjet tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e studentëve frekuentojnë shpesh sekretarinë mësimore, ndërsa një pjesë e tyre e vizitojnë rrallë. Ky ndryshim mund të reflektojë faza të ndryshme të vitit akademik (p.sh., regjistrimet, provimet, afatet e dorëzimit të dokumentacionit), por gjithashtu mund të tregojë se disa studentë gjejnë zgjidhje alternative ose nuk kanë nevojë për ndihmë të vazhdueshme

Cilësia e përgjigjeve të dhëna nga sekretaria mësimore, përgjigjet e studentëve ndahen në disa kategori, duke filluar nga "Shumë mirë" deri te "Jo të mjaftueshme" dhe "Asnjëherë". Kjo tregon një ndarje në përvojat e studentëve. Një pjesë e studentëve vlerësojnë pozitivisht marrjen e përgjigjeve të qarta dhe të drejtpërdrejta. Përgjigjet janë 89.7% (shumë të mira), 6.9% (shumë mire) dhe 3.4% (mire).

Etika e komunikimit kjo pyetje, e vlerësuar kryesisht me notën 5, tregon se stafi administrativ kryesisht respekton etikën e komunikimit. Kjo është një pikë e fortë që duhet vlerësuar.



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE STANDARDEVE TËCILËSISË

Në lidhje me pyetjen për ndonjë përmisim që duan në lidhje me sekretarinë mësimore, përgjigjet janë pozitive. Pjesa më e madhe përgjigjeve janë nuk kemi sugjerime jemi të kënaqur.

Pyetja pjesëmarrja në aktivitete sportive është vlerësuar me 82.4% (ndonjëherë), 11.8% (asnjëherë) dhe 5.9% (rradhë).


Pjesëmarrja në panairin e punës dhe karrierës është vlerësuar me 37.9% (rrallë), 31% (asnjëherë), 20.7% (shpeshherë) dhe 10.9% (gjithmonë).

Pyetja nëse janë të mjaftueshme aktivitetet në UAMD është vlerësuar pozitivisht me 20.7% (mëse të mjeftushme), 58.69% (të mjeftushme) dhe 20.7% (jo shumë të mjaftueshme).

Plotësimi i nevojave me literaturë: Vetëm 27.6% e studentëve janë të kënaqur me literaturën e bibliotekës, ndërsa një përqindje e ngjashme (27.6%) është neutrale dhe 24.1% shprehen se literatura nuk i plotëson nevojat.

Ndihma e personelit: 34.5% e studentëve theksojnë se personeli i ka ndihmuar shpesh, por vetëm 10.3% gjithmonë. Kjo tregon nevojën për një angazhim më të vazhdueshëm të stafit të bibliotekës.


Frekuentimi i bibliotekës online: 41.4% e studentëve nuk e kanë përdorur asnjëherë, ndërsa vetëm 6.9% e kanë përdorur shpesh. Kjo tregon mungesë informacioni ose vështirësi në përdorim.





UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E KURRIKULËS, CILËSISË DHE STATISTIKAVE


Pjesëmarrja në konferenca studentore: Vetëm 10.3% kanë marrë pjesë realisht, ndërsa 27.6% janë informuar por nuk kanë marrë pjesë. Pjesa më e madhe (55.2%) shprehet se dëshiron të marrë pjesë, por nuk ka pasur informacion të mjaftueshëm



- Jam informuar, por nuk kam marrë pjesë
- Dua të marr pjesë, por nuk kam informacion
- Kam marr pjesë
- Nuk jam i/e intersuar

Pajisjet laboratorike: 58.6% e studentëve mendojnë se pajisjet janë "të pamjaftueshme", dhe vetëm 10.3% i vlerësojnë si "mjaftueshme".

Përdorimi i laboratorëve për punë të pavarur kërkimore: 41.4% e studentëve deklarojnë se nuk i përdorin asnjëherë laboratorët, ndërsa vetëm 6.9% i përdorin shpesh. Kjo tregon mungesë përfshirjeje në aktivitetet kërkimore apo akses të kufizuar.




- Mëse të mjaftueshme
- Të mjaftueshme
- Të pa mjaftueshme




UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE STANDARDEVE TËCILËSISË

Vlerësimi i platformës Pitagora: 37.9% e vlerësojnë "shumë mirë", ndërsa 62.1% "mirë", pa vlerësime negative. Kjo tregon kënaqësi të përgjithshme me funksionalitetin e saj.




Mjaftueshmëria e informacionit online: 65.5% e studentëve mendojnë se informacioni në faqen zyrtare është "më së të mjaftueshëm", ndërsa 27.6% "të mjaftueshëm". Pra, mbi 90% janë të kënaqur me transparencën dhe informacionin online.





UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E KURRIKULËS, CILËSISË DHE STATISTIKAVE

Vlerësimi i kushteve infrastrukturore dhe higjiëno-sanitare: 75.9% i vlerësojnë si "të këqija", 13.8% "shumë të këqija", dhe vetëm 10.3% kanë mendim pozitiv. Ky është një tregues i qartë i nevojës për përmirësime infrastrukturore dhe rritje të standardeve higjiënike



5. Përfundime dhe rekomandime

Nga rezultatet e pyetësorit, vihet re se studentët janë përgjithësisht të kënaqur me:

- 1.Funksionimin e platformës Pitagora,
- 2.Informacionin online të institucionit.

Ndërkohë, fushat që kërkojnë përmirësim janë:

- 1.Pajisjet laboratorike dhe përdorimi i tyre për punë kërkimore,
- 2.Infrastruktura dhe higjiëna e ambienteve,
- 3.Pasurimi i bibliotekës me literaturë bashkëkohore,
- 4.Informimi më i mirë për aktivitetet studentore (konferenca, trajnime etj.).

Rekomandohet:

Rritja e investimeve në pajisje laboratorike dhe mirëmbajtjen e tyre.

Hartimi i një plani për promovimin e bibliotekës online dhe trajnimin e studentëve për përdorimin e saj.



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
DREJTORIA E KURRIKULAVE DHE STANDARDEVE TËCILËSISË

Përmirësimi i kushteve higjieno-sanitare në ambientet universitare.

Pasurimi i fondit të literaturës me materiale të reja dhe burime digjitale.

Forcimi i komunikimit me studentët përmes njoftimeve më të rregullta mbi aktivitetet kërkimore dhe konferencat studentore.

Mbetemi në dispozicion për diskutime të mëtejshme dhe për të dhënë detaje shtesë mbi gjetjet dhe rekomandimet.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTORIA E KURRIKULËS, CILËSISË DHE STATISTIKAVE

Dr. Spiro PAÇO